

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025 (java e shtatëmbëdhjetë, deri më 27.04.2025)

TË DHËNA JAVORE


Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë javës së shtatëmbëdhjetë të vitit 2025 (nga 21-27.04.2025) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **114 (I=6,2/100.000)** raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 26,5% më pak se javën e kaluar.

Krahasuar me javën e shtatëmbëdhjetë të vitit të kaluar (102) numri është rritur për 11,8%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (64) është regjistruar një rritje prej 78,4%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit korrespondon me aktivitet jashtësezonal të virusit (Grafiku 1).

Grafiku 1. Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025



82 raste janë regjistruar tek grupmosha 15-64 vjet, 15 tek fëmijët nga 5-14 vjet, 11 tek personat mbi 65 vjet dhe 6 tek fëmijët nga 0-4 vjet. Incidencë më e lartë (7,0/100.000) është regjistruar tek fëmijët nga 5-14 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në 13 QSHP/NJR : Shkup – 46, ndërsa në të tjerat numri është ≤15.

Nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së shtatëmbëdhjetë janë raportuar gjithsej 24 raste me SARI. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=20; 83,3%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje respiratore të fëmijëve - Kozle. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=16; 66,6%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 229, asnjë person nuk është i shtruar në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet 10,5% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (rutinore + SARI)

Në javën e shtatëmbëdhjetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 18 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI.

Nuk është regjistruar rast pozitiv me grip.

Janë testuar 6 mostra për RSV, ndërsa tek 2 është vërtetuar RSV – A dhe tek 1 RSV-B.

TË DHËNA KUMULATIVE

Mbikëqyrja epidemiologjike

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 25.882 (I=1.409,1/100.000)

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=15.010), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rritje prej 72,4%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=20.868) është regjistruar një rritje prej 24%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 29 QSHP/NJR. Numri më i madh (n=6.977) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (5.550,9/100.000) është regjistruar në territorin e Dibrës (1.062).

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) – 14.840 raste (57,3%), ndërsa incidencë më e lartë (3.087,4/100.000) tek fëmijët e moshës 0-4 vjet (n=2.980).

Shpërndarja e rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas muajve:

- tetor – 195 raste ose 0,8%
- nëntor – 259 raste ose 1,0%
- dhjetor – 570 raste ose 2,2%
- janar – 7.710 raste ose 29,8%
- shkurt - 11.210 raste ose 43,3%
- mars – 5.067 raste ose 19,6%
- prill (deri më 27.04.2025) – 871 raste ose 3,3%.

Deri më tani janë regjistruar 5 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si mbikëqyrje shitesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes së gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e që ka për qëllim fitimin e informacionit më të detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për zbatimin e masave parandaluese në kohë. Mbikëqyrja sentinel SARI kryhet në 6 spitale mbikëqyrëse, 5 në Shkup (KU e Sëmundjeve Infektive dhe Gjendjeve Febrile, KU për Sëmundjet e Fëmijëve, KU e Alergologjisë dhe Pulmologjisë, SPQ 8 Shtatori dhe KU për Sëmundje Respiratore tek Fëmijët - Kozle) në një në Shtip (SK Shtip). Definicioni për rastet SARI sipas të cilit zbatohet mbikëqyrja është në përputhje me definicionin e rastit të dhënë nga OBSH-ja në vitin 2014.

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së shtatëmbëdhjetë janë raportuar gjithsej 1.212 raste me SARI, me 20 persona në kujdes intensiv. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=460; 38,0%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje tek fëmijët. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=614; 50,6%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 7.200. Nga të gjitha pranimet, 16,8% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë prej 20,4% është regjistruar tek personat e grupmoshës nga 0-4 vjet.

Janë regjistruar 9 raste të vdekjes, 2 në moshë nga 30-64 dhe 7 mbi 65 vjet, me komorbiditete dhe të pavaksinuar. Tek katër prej tyre është vërtetuar Influenza, dhe atë: 2 raste me Influenza A(H3), 1 me Influenza A(H1)pdm09 dhe 1 me Influenza A - e patipizuar.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (rutinore + SARI)

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e shtatëmbëdhjetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 1.182 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Të gjitha materialet janë testuar edhe për prani të virusit të gripit, SARS-CoV-2 dhe / ose RSV.

Janë detektuar 285 raste pozitive me grip. (Tabela 1)

Janë regjistruar 10 raste pozitive me SARS-CoV-2 dhe 104 raste me RSV.

Tabela 1. Shpërndarja, numri dhe përqindja e materialeve pozitive nga mbikëqyrja rutinore dhe sentinel sipas origjinës dhe numrit, RMV, 2024/2025

Lloji dhe nënlloji i virusit	Origjina		Sezoni 2024/25	
	rutinor	Sentinel SARI	numri	%
Influenza A	86	86	172	60,4%
Influenza A/H1pdm	15	25	40	23,3%
Influenza A/H3	64	54	118	68,6%
Influenza A – e pasubtipizuar	7	7	14	8,1%
Influenza B	81	32	113	39,6%
Influenza B Victoria	80	32	112	99,1%
Influenza B – linjë e papërcaktuar	1	0	1	0,9%
SARS-CoV-2	6	4	10	-
RSV	15	89	104	-
RSV-A	9	61	70	67,3%
RSV-B	6	28	34	32,7%

KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Numri i sëmundjeve të ngjashme me gripin, po shënon rënie por vazhdon të jetë mbi kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e mbikëqyrjes virologjike të gripit tregojnë se ka një aktivitet të ulët të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënave, Maqedonia e Veriut ka intensitet mesatar të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.376 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.923 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 72.300 persona me vakcina falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e gjashtëmbëdhjetë të vitit 2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 4 nga 28 vende të rajonit evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit vazhdoi të bjerë dhe është nën pragun epidemik prej 10% për herë të parë që nga fillimi i sezonit. Ka një dominim të ndryshueshëm të influenza A dhe B në të gjithë rajonin.
- Pozitiviteti i RSV në mbikëqyrjen sentinel ka rënë krahasuar me kulmin e arritur në fund të dhjetorit, por mbetet i lartë dhe është më i larti në grupmoshën 0-4 vjeç.
- Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët në nivel rajonal, me disa variacione në nivel vendi.

Nga 30 vende të cilat raportojnë për intensitetin e gripit: 5 kanë raportuar për intensitet mesatar dhe të lartë.

Nga 29 vende të cilat raportojnë për shpërndarjen gjeografike të gripit: 17 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë të virusit të gripit.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik